

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Data 28.02.2025  
Ora 12:10**

**RENDI I DITËS**

**“Për shqyrtimin e kërkesave së partive politike për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.**

**PJESËMARRJA:**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu**
- **Parti politike:**      **Z. A. Goxhaj**
- **OJQ:**      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite shqyrtimin e disa kërkesave për regjistrim të partive politike si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 11 maj 2025, shqyrtimin e projektvendimit që ka të bëjë me miratimin e disa elementëve përmbajtjesorë të fletës së votimit, si dhe të specimentit të saj; projektvendimin “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2025” dhe do të përfundojmë me shqyrtimin e disa denoncimeve të KRIIK dhe të Partisë Demokratike.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesave për regjistrim si subjekte zgjedhore: Partia Aleanca Socialiste Shqiptare, Partia Aleanca Konservatore dhe Partia Aleanca Europiane Ekologjike.

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Znj. L. Veliu:** Në kuadër të procesit të regjistrimit si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, kanë depozituar pranë KQZ-së kërkesat e tyre partitë politike si vijon: Partia Aleanca Europiane Ekologjike me kryetar Sazan Gurin; Partia Aleanca Socialiste Shqiptare me kryetar Gëzim Alibalin, Partia Aleanca Konservatore për Shqipërinë me kryetar Altin Goxhaj. Bashkëlidhur kërkesës nga secila parti politike është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në referim të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimit nr. 2 i datës 22 janar 2025 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

Bazuar në shqyrtimin e dhe verifikimin e kryer, dokumentacioni shoqëruar i paraqitur nga partitë politike: Partia Aleanca Europiane Ekologjike me kryetar Sazan Gurin dhe Partia Aleanca Socialiste Shqiptare me kryetar Gëzim Alibalin janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me Partinë Aleanca Konservatore për Shqipërinë me kryetar Altin Goxhaj, sqarojmë si vijon: në datën 25 shkurt zoti Goxhaj ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën për të regjistruar partinë politike “Partia Aleanca Konservatore për Shqipërinë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025. Në bazë të kriterëve të nenit 64/2, germa “a”, zoti Goxhaj ka depozituar vendimin e shkurtuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm , shpallur në datën 21.2.2025, ku vendimi citon se ndryshohet emri i partisë nga Partia Aleanca Europiane Ekologjike në Parti Aleanca Konservatore për Shqipërinë. Vendimi nuk ka marrë formë të prerë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! E shoh që është zoti Goxhaj prezent. Keni për të bërë ndonjë sqarim shtesë në lidhje me sa u relatua?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Z. A. Goxhaj:** Po, i nderuar. Ne e kemi sjellë kërkesën sot për ta tërhequr aplikimin për regjistrimin e Aleancës Konservatore për faktin se në datën 9 mars ai merr formë të prerë dhe atë ditë ne do të sjellim nga gjykata kërkesën për ndryshimin e emrit, sepse një partie që i ndryshohet emri dhe merr vendim të formës së prerë, automatikisht është i detyruar ta ndryshojë emrin në çdo institucion, që në këtë rast është edhe KQZ-ja.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë do të pranojmë:

- Kërkesën për regjistrim të Partisë Aleanca Europiane Ekologjike me kryetar Sazan Gurin.

Në momentin që ndryshimet do të bëhen efektive si për emrin, ashtu edhe për drejtuesin e kësaj partie, do t'i reflektojmë. Dakord?

**Z. A. Goxhaj:** Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Ndërkohë, regjistrojmë si subjekt zgjedhor edhe Partinë Aleanca Socialiste Shqiptare me kryetar Gëzim Alibalin.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Data 28.02.2025  
Ora 12:14**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.**

**PJESËMARRJA:**

• **KQZ**

- |                                       |                                     |
|---------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | <b>Z. Ilirjan Celibashi</b>         |
| 2. Staf i KQZ:                        | <b>Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu</b> |
| • <b>Parti politike:</b>              | <b>PD (F. Nuri), z. A. Goxhaj</b>   |
| • <b>OJQ:</b>                         | <b>KRIIK</b>                        |

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit, si dhe specimentit të saj, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

**Z. L. Veliu:** Neni 97, pika 1, parashikon se për zgjedhjet për Kuvend, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore. Referuar nenit 98 të Kodit Zgjedhor, fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve, që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

me sy të lirë. Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë edhe disa elemente teknike në formën e kodeve, që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë (QR code). Të gjithë këto elemente janë përcaktuar në vendimin nr. 6, datë 6.2.2025 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025” dhe në vendimin nr. 7, datë 14.2.2025 “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë elementët përmbajtësorë që do të këtë fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, pra ato elementë që, pavarësisht përmbajtjes së fletës së votimit që do të miratohet rast pas rasti, do të jenë të njëjtë në çdo tip të fletës së votimit pavarësisht zonës zgjedhore përkatëse. Elementët përmbajtësorë janë listuar në lidhjen 1 që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe përbëhen nga: a) elementë të përgjithshëm, b) elementë në formën e tekstit dhe c) elementë në formën e kuadrateve. Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave, i kërkohet miratimi i këtij projektvendimi.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në lidhje me këtë model? Po, zoti Goxhaj.

**Z. A. Goxhaj:** I nderuar zoti kryetar, problemi i këtyre është vetëm numri, sado të jenë gërmat e shkruara, duhet patjetër të krijohet raporti i numrit me emrin. Aty mungon numri. Pa numër si do të arrijë të identifikojë votuesi të zgjedhurin e tij dhe

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

vetë kandidati që pretendon që të komunikojë ekzistencën e tij. Pra, numri është një identitet i domosdoshëm përkrah emrit.

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

**Z. F. Nuri:** Nuk kemi ndonjë vërejtje në formë e në përmbajtje të përgjithshme. Ajo që ka rëndësi për ne është të respektohen kriteret e Kodit Zgjedhor, që të kandidimi të jetë me emër, me mbiemër, sikurse e ka përcaktuar edhe Kodi Zgjedhor. Pastaj teknikalitetet, forma, formati e të tjera, varen nga numri i subjekteve që do të regjistrohen dhe KQZ-ja e di më mirë këtë pjesë.

**Z. I. Celibashi:** Atëherë për saktësim ose për sqarim të asaj se çfarë do të përmbajë fleta e votimit për zgjedhjet e datës 11 maj, natyrisht do të jetë vendi për shënimin e zgjedhësit si për partinë politike dhe koalicionet, ashtu edhe për kandidatët që i nënshtrohen votimit parapëlqyes, do të jenë shkronjat nistore dhe logoja e çdo subjekti zgjedhor, stema e Republikës, logoja e KQZ-së, emrat e subjekteve zgjedhore, parti politike, koalicion dhe emrat e kandidatëve në listën shumëmemërore. Kandidatët, të cilët do të jenë në pjesën e mbyllur të listës, do të shfaqen edhe ata në fletën e votimit të renditur, ashtu sikurse do t'i sjellin partitë politike dhe koalicionet, ndërsa kandidatët që do t'i nënshtrohen votimit parapëlqyes do të jenë aty vetëm me emër e mbiemër, sepse Kodi Zgjedhor kështu e përcakton, radhitja e tyre është në bazë të rendit alfabetik të mbiemrit. Ajo çfarë tha zoti Goxhaj nuk mund të aplikohet në këtë rast, pas ndryshimeve të bëra, sepse radhitje ka vetëm për ata që qëndrojnë në listën shumëmemërore, pjesa tjetër e kandidatëve do të renditen, nuk do të radhiten, sipas rendit alfabetik të mbiemrit. Në pamje ky do të jetë specimenti i fletës së votimit, dhe ashtu sikurse tha edhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike, në varësi të numrit të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse, do të ndryshojë më së paku përmasa e fletës së votimit. Faleminderit!

**Vendimi nr.230**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 3

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Data 28.02.2025  
Ora 12:20**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2025”.**

**PJESËMARRJA:**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Znj. P. Doçaj, L. Veliu**
- **Parti politike:**      **PD (F. Nuri), A. Goxhaj**
- **OJQ:**      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës.

**Z. L. Veliu:** Në zbatim të nenit 19, pika 2, të ligjit “Për partitë politike”, i ndryshuar, si dhe të vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues”, shuma e dhënë nga buxheti i shtetit për t’u shpërndarë partive politike si ndihmë financiare vjetore është si më poshtë: Përlllogaritet 70% e vlerës totale 345 600 000 lekë të miratuar nga buxheti i shtetit. Kjo vlerë është e barabartë me 241 920 000 lekë. Ky total pjesëtohet me numrin e deputetëve të parlamentit shqiptar, 140 deputetë. Rezultati 1 728 000 lekë i dalë nga pjesëtimi shumëzohet me numrin e

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

deputetëve të secilës parti politike që ka fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. 20% e shumës totale ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Përlllogaritet 20% e vlerës 345 600 000 lekë të miratuar nga buxheti i shtetit.

Përlllogaritet 10% e vlerës 345 600 lekë të miratuar nga buxheti i shtetit. Kjo vlerë është 34 560 000 lekë shumëzohet me përqindjen përkatëse të partive politike, të cilat kanë fituar mbi 1% të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvend. Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10% i shtohet fondit prej 70% dhe u ndahet partive parlamentare në bazë të mandateve të fituara në zgjedhjet e datës 25 prill 2021. Në përfundim vlera totale që përfiton secili parti politike si mbështetje financiare për vitin 2025 është shumatorja që rezulton nga përlllogaritjet e mësipërme.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i kërkohet të shqyrtojë e të miratojë projektvendimin “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2025”.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

**Z. F. Nuri:** Jo, nuk kemi ndonjë koment.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Fondet që përfitojnë partitë politike, fondet vjetore, si ndihmë financiare vjetore për partitë politike do të shpërndahen si vijon: Për Partinë Socialiste të Shqipërisë 151 milionë 494 mijë e 783 lekë; për Partinë Demokratike 106 milionë 661 mijë e 181 lekë; Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet 9 milionë 753 mijë e 658; Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 8 milionë e 18 mijë 647 lekë;

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 2



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

Partia Republikane Shqiptare 11 milionë 488 mijë e 669 lekë; Partia Agrare Ambientaliste 8 milionë 18 mijë e 647 lekë; Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar 8 milionë 18 mijë e 647 lekë; Partia Lëvizja e Legalitetit 8 milionë 18 mijë e 647 lekë; Partia e Lirisë 15 milionë 577 mijë e 215 lekë; Partia Socialdemokrate 12 milionë 266 mijë e 269 lekë dhe e fundit Partia “Nisma Thurje” 6 milionë 283 mijë e 636 lekë. Secila prej këtyre partive do t’i përfitojë këto fonde pasi të ketë depozituar në KQZ raportin financiar për të ardhurat dhe shpenzimet vjetore financiare të vitit 2024 brenda datës 31 mars të këtij viti, është afati për depozitimin e këtij raporti. Me depozitimin e këtij raporti do të bëhet shpërndarja e fondeve për secilën parti politike të listuara.

**Vendimi nr. 223**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 3

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Data 28.02.2025  
Ora 12:24**

***RENDI I DITËS***

**Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 8, datë 10.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike.**

**PJESËMARRJA:**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Znj. P. Doçaj**
- **Parti politike:**      **PD (F. Nuri)**
- **Të tjerë**      **Bashkia Kolonjë (E. Isai)**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit të Partisë Demokratike.

**Znj. P. Doçaj:** Faleminderit! Denoncimi i regjistruar me nr. 8, denoncues është Partia Demokratike. Subjekti i denoncuar është zoti Erion Isai, kryetar i Bashkisë Kolonjë. Objekti i denoncimit ka të bëjë me përdorimin e burimeve publike dhe funksionit publik në mbështetje të subjekteve zgjedhore.

Sipas pretendimit të denoncuesit: “Kryetari i Bashkisë Kolonjë ka nisur të shpërdorojë fondet publike për të udhëtuar drejt Greqisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me qëllimin e vetëm për të bërë fushatë politike dhe për të ndikuar te emigrantët për zgjedhjet e datës 11 maj 2025. Zoti Isai, në kundërshtim të hapur me

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**

 1

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

ligjin, regjistron emigrantët në PER në favor të Partisë Socialiste, duke përdorur funksionin e tij publik për të favorizuar një parti politike”.

Në datën 14.02.2025 ka filluar hetimi administrativ nga ana jonë. Është një çështje e mbartur nga seanca e fundit dhe nuk ka ndonjë pretendim të depozituar me shkrim, por sot është vetë prezent zoti Erion Isai, kryetari i Bashkisë Kolonjë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Para se t’ia fjalën zotit Erion Isai, përfaqësuesi i Partisë Demokratike ka diçka për të shtuar më shumë në lidhje me këtë?

**Z. F. Nuri:** Faleminderit, zoti Celibashi! Në lidhje me këtë rast për të cilin në datën 14 shkurt KQZ-ja ka filluar edhe hetimin administrativ, ne u qëndrojmë pretendimeve tona dhe doja të fokusohesha në disa data që kemi cituar tek ankimimi administrativ, që kanë të bëjnë me data që janë data pune, faktikisht, nuk janë data as në fundjavë, as festa zyrtare, 14 janari, 24 janari, 20 janari, 22 janari dhe data të tjera, që ne i kemi cituar këtu. Janë ditë pune. Bëhet fjalë për 14 janarin që është ditë e martë, 20 janari ditë e hënë, 22 janari ditë e mërkurë. Në këto data në rrjetet sociale të kryetarit të bashkisë janë postuar aktivitete të ndryshme në diasporë, kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Kanada, në mos gaboj, ku ndër të tjera ka lidhje me votën e diasporës, apo edhe në Selanik të Greqisë një rast i caktuar. Ne mendojmë që të gjitha këto aktivitete të kryera brenda ditëve të punës janë shkelje të Kodit Zgjedhor, ndaj ne e konsiderojmë që KQZ-ja duhet të marrë masat administrative përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Zoti Isai.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Z. E. Isai:** Shumë faleminderit për këtë dëgjese dhe për mirëkuptimin e mungesës të mbledhjes së parë. Për saktësim nuk kam qenë jashtë në mbledhjen e fundit, por kam qenë në një event, të miratuar nga KQZ-ja, për një marrëveshje midis Autoritetit të Dosjeve dhe Bashkisë Kolonjë për një projekt mbi Shtegun e Lirisë, vrasjet në kufi. Nuk kam qenë jashtë. Edhe që nuk ka përgjigje, nuk është e vërtetë. Ju keni një përgjigje bashkëlidhur me të gjitha dokumentet e nevojshme për të hedhur poshtë çdo pretendim që asetet shtetërore të Bashkisë Kolonjë janë përdorur për fushatë. Gjatë udhëtimit tim në Amerikë jam pajisur me lejen ime të zakonshme të mbartur të vitit 2024, lejuar nga ligji deri në fund të marsit 2025. Pra, kam të drejtë të përdor lejen time të zakonshme për të ushtuar aktivitetin tim politik. Do ta vazhdoj ta ushtroj aktivitetin tim politik për sa ditë kam ende leje dhe çdo fundjavë. Konkretisht, këtë fundjavë do të jem në Londër, sepse unë jam njeri politik, patronazhist pa asnjë problem, do të vazhdoj ta ushtroj këtë funksion. Nuk ka asnjë ligj që të më ndalojë mua të bëj fushatë për subjektin që besoj, që duhet ta mbështes dhe patjetër që duhet të fitojë. Rrjetet e mia sociale janë produkt imi personal. Faqet e mia virtuale janë 9 herë e gjysmë më të mëdha sesa numri i banorëve që kryetari i bashkisë drejton sot në Kolonjë. Ajo është një pronë imja personale dhe do ta përdor siç unë e shoh të arsyeshme brenda etikës, brenda ligjit, brenda rregullave. Bindjet e mia politike do të vazhdoj t'i shpreh sa të kem mundësi. Miqtë e mi emigrantë do të shkoj t'i takoj sa të kem mundësi. Ju ftoj, të nderuar përfaqësues të subjektit politik të Partisë Demokratike, të bëni kallëzim edhe në SPAK, nëse dëshironi. Asnjë qindarkë nga buxheti i Bashkisë Kolonjë nuk është përdorur. Aty është regjistri i prokurimeve publike, hapeni, gjejini një biletë avioni që është shfrytëzuar ky fond, që mua më është prerë bileta e avionit nga Bashkia e Kolonjës. Për udhëtimet e mia në Greqi, aty është sistemi TIMS, gjejini targën e makinës nëse është shtetërore apo private. Jam mjaftueshëm i rritur dhe i qartë për detyrën që kam për ta kuptuar që është tjetër

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 3

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

gjë funksioni im politik, është tjetër gjë funksioni im publik. Detyrën e kryetarit të bashkisë do të vazhdoj ta ushtroj me integritet të plotë. Detyrën si patronazhist dhe përfaqësues i Partisë Socialiste do ta vazhdoj me vrull dhe integritet të plotë ta ushtroj duke mos përdorur asnjë orë e sekondë, as administratën, as fondet publike dhe as asetet publike të Bashkisë Kolonjë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, zoti Isai, për të gjitha shpjegimet që dhatë! Natyrisht, si për institucionin tonë, por edhe për përfaqësuesit e Partisë Demokratike nuk ka pikë interesi se si performoni ju për angazhimet tuaja politike. Diskutimi ka të bëjë për atë sa sa dhe nëse ju keni shfrytëzuar, edhe në përputhje me parashikimet e ligjit, funksionin tuaj si kryetar bashkie, kurse pjesa tjetër nuk është me interes për ne. Ka diçka tjetër për të thënë në lidhje me këtë? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

**Z. F. Nuri:** Faleminderit, zoti Celibashi! Nga ato që dëgjuam, ne mbajmë këtë qëndrim: i qëndrojmë plotësisht asaj që kemi depozituar me shkrim si ankimim. Aty nuk kemi referuar në mënyrë të detajuar shkelje të burimeve të bashkisë në veçanti, por ka qenë dhe është detyra e kryetarit të bashkisë që është etiketuar nga ana jonë, sepse është vetë kryetari i bashkisë që në ditë pune, sipas pretendimit tonë, ka qenë në aktivitete. Kryetari i bashkisë konsiderohet pjesë e administratës publike, në këtë kuptim. Por zoti Isai sot erdhi me pretendimin që paska qenë me leje vjetore. Nuk e di nëse është administruar si provë. Këto duhen verifikuar, duhen parë, por përtej kësaj, ne nuk jemi të mendimit që kryetari i bashkisë dhe cilido kryetar bashkie ka të drejtë të bëjë propagandë apo fushatë, qoftë edhe në diasporë apo të merret me regjistrimin eventualisht të diasporës në PER, sikurse ka ndodhur edhe në raste të tjera. Sa për faqen e *facebook*-ut, ju keni si KQZ praktika të gjëra në lidhje me këto,

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**

 4

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

sepse është ajo vija e hollë e diferencës midis privates dhe publike, sa u takon personaliteteve publike, shumicën e rasteve janë konsideruar si profile të funksionit, aq më tepër kur në faqen e tij të *facebook*-ut zoti Isai ka shkruar që është kryetar i Bashkisë Kolonjë. Prandaj ato njësohen, pra privatja me publikën dhe çdo publikim që ju bëni, ne jemi të mendimit që ka ndikim patjetër në aspektin politik. Përsërisim edhe një herë që ka pasur shkelje, sepse është vetë kryetari i bashkisë që ka pasur qëndrim proaktiv, ka dalë dhe ai është pjesë e administratës publike në vetvete. Prandaj kërkojmë pranimin e kërkesës nga KQZ-ja dhe marrjen e masave administrative. Për sa u përket masave penale, ajo është diçka që u takon organeve ligjzbatuese. KQZ-ja ka bashkëpunim edhe me SPAK-un dhe SPAK-u ose edhe prokurori të tjera, Prokuroria e Përgjithshme, janë shprehur se do të kenë vëmendje të shtuar në këtë periudhë, ndaj u takon atyre nëse e gjejnë të arsyeshme, të marrin masat që i takon si institucion për të parë ligjshmërinë e veprimeve të çdokujt në këtë periudhë parazgjedhore.

**Z. I. Celibashi:** E fundit për zotin Isai.

**Z. E. Isai:** Besoj që administrata e KQZ-së e ka këtë imeil qysh para seancës së parë, janë bashkëlidhur leja ime vjetore e miratuar dhe listëprezenca e muajit janar hedhur në sistem, ku ditët e punës janë shënuar ditë pune, ditët e lejes janë shënuar ditë leje, unë nuk e di si mund të lidhësh të drejtën që ma njuh ligji të bëj leje të zakonshme me faktin që edhe kur jam me leje të zakonshme duhet të rrijë në zyrë, se jam kryetari i bashkisë.

Për sa u përket rrjeteve të mia sociale, unë kam jetë publike që prej vitit 2004, jam artist i skenës dhe ekranit qysh prej vitit 2004. Në bion time sigurisht që shënohet që jam kryetar i Bashkisë Kolonjë, shënohet që jam edhe babai i Ajër dhe i Dua,

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 5

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

shënohet që jam artist, regjisor, skenarist. Para pak minutash kam bërë postim për “Karnavalet e Korçës” në Teatrin Kombëtar, që është produkt i krijimtarisë sime. Kjo nuk është fushatë. Pa dyshim që do të vazhdoj të postoj dhe nuk mund të ndërliken dhe nuk ka ligj që lidh faqen time publike, po është atributi im privat, me faqen e Bashkisë Kolonjë. Ju sfidoj të hapni faqet e Bashkisë Kolonjë dhe nëse gjeni një postim timin në aktivitetin politik, unë dorëzoj mandatin. Jo gjobën administrative, unë dorëzoj mandatin sot, këtu në KQZ. Faqet e Bashkisë Kolonjë në *facebook* dhe *instagram* janë faqet e Bashkisë Kolonjë. Faqet e Erion Isait janë faqe të Erion Isait, ndaj do t’ju lutesha KQZ-së ta hedhë poshtë këtë pretendim. Fjalja e fundit, se shoh shumë njerëz që ndërkohë, para se të fillonte, ishin të terrorizuar nga kjo histori, si gjithmonë ne shqiptarët e ngatërrojmë atë fillin e hollë, edhe ligjin njerëzit e bëjnë, jeta virtuale e çdo individi, është jetë virtuale e çdo individi. Duhet të fillojmë ta pranojmë si koncept jetën virtuale. Kemi një administratë të tërë të terrorizuar mos marr gjobë pse bën një postim pse do. Nuk ngatërrohet kush me vullnetin e lirë. Edhe pretendimi i zotërisë që thotë ju keni regjistruar në PER. Po, kam regjistruar në PER, por nuk mund të regjistroj në PER duhet të dhëna personale dhe nëse dikush si aktori i mirënjohur, miku im që prej vitit 2004 Arben Dervishi, sepse kjo është në video, merre dhe hape, ma beson mua kartën e identitetit, fytyrën e vet ta skanojë, sepse nuk di ta bëjë, do ta bëjë. Por kur dikush i hap gjyshes *e-albania-n*, ka shkelur ligjin? Nuk di gjyshja ta hapë *e-albanian-n*. Por kur dikush i bën regjistrimin në PER babait, nënës? Për sa kohë ka të dhëna personale që dikush t’i beson, nuk ka ligj në botë që mua më ndalon. Dikush nuk di ta bëjë dhe ka qejf t’ia bëjë unë, ia bëj unë atë shërbim. Ju nuk mund të lidhni detyrën time si kryetar i bashkisë me vizitën time personale në Miçigan ditët e lejes sime të zakonshme.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 6

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, zoti Isai! Do të ishte me vend që të kishit evituar deklarime që nuk kanë të bëjnë me objektin e çështjes, pavarësisht se mund ta mirëkuptoj merakun dhe shqetësimin tuaj për gjendjen e pjesëtarëve të tjerë në këtë shqyrtim. Në fund, qoftë edhe nga pikëpamja formale procedurale, ishte e pavend, por, gjithsesi, e tejkalojmë. Keni gjë tjetër për të thënë? Nga sa më referohet prej stafit të KQZ-së, na mungon imeili informues a sqarues së bashku me dokumentet përkatëse. Nëse i keni si dokumentacion këtu me vete, mund t'i depozitoni.

**Z. E. Isai:** Unë e kam imeilin këtu, nuk e di pse nuk ka ardhur. Nëse më ndihmon dikush nga stafi në moment e dërgoj. Bashkëlidhur është leja ime e zakonshme bashkë me borderonë e datave që pretendohet e skanuar.

**Z. I. Celibashi:** Dakord. Nëse nuk kemi gjë tjetër, po e përfundojmë hetimin administrativ. Për vendimin do të njoftoheni në ditët në vijim, nëse nuk keni gjë tjetër për të depozituar.

**Vendimi nr. 221**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Data 28.02.2025  
Ora12:39**

**RENDI I DITËS**

**Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 16, datë 14.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.**

**PJESËMARRJA:**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti politike:**      **PD (F. Nuri)**
- **OJQ:**      **KRIIK**
- **Të tjerë:**      **Përfaqësues të subjekteve të Denoncuar.**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me çështjet e tjera të tjera të rendit të ditës, me denoncimet e organizatës KRIIK.

**Znj. P. Doçaj:** Po, ka të bëjë me pikën 7 të rendit të ditës, me denoncimin nr. 16, denoncues është Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK. Subjekte të denoncuar janë 25 zyra vendore të arsimit parauniversitar: Tiranë, Durrës; Korçë-Pustec; Bulqizë; Mat; Pukë; Kukës; Kurbin; Shkodër; Librazhd; Pogradec; Berat; Klos; Rrogozhinë; Fier; Dropull; Tepelenë-Memaliaj;

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

Lushnje; Mallakastër; Patos; Sarandë, Konispol, Delvinë; Peqin; Elbasan; Krujë dhe Përmet.

Objekti i denoncimit ka të bëjë me përdorimin e postimeve të aktiviteteve institucionale të zyrave vendore të arsimit parauniversitar, institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të sloganeve/hashtagëve partiakë/elektoralë.

Pretendimet e denoncuesit janë si vijon: “Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në *facebook* të disa institucioneve, në rastin konkret të 25 institucioneve të arsimit parauniversitar, janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtagëve. Këto slogane është vërejtur se i përmbajnë faqet zyrtare të këtyre institucioneve. Nisur nga ky denoncim në datën 14.02.2025, KSHZ filloi hetimin administrativ.

KQZ administroi pretendimet e të gjitha zyrave vendore, të cilat njëzëri kanë deklaruar se të gjitha postimet kanë të bëjnë me punën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe punën e institucioneve të varësisë. Të gjitha institucionet thonë që nuk kishin dijeni për këto hashtagë, që kanë përmbajtje elektorale. “Jemi të angazhuar që të fshijmë këto postime, si dhe të mos përsëriten më”. Janë kontrolluar nga ana jonë dhe janë fshirë të gjitha postimet objekt i këtij denoncimi. Janë lajmëruar dhe marrin pjesë në mbledhjen e sotme të gjitha institucionet, përveç institucionit parauniversitar Tiranë, Pogradec.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e institucioneve, të cilët u referuan në këtë denoncim, dëshirojnë të flasin?

**Përfaqësuese e ZVA, Durrës:** Unë jam drejtoresha e Zyrës Arsimore Durrës. Kemi marrë njoftim nëpërmjet imeilit nga KQZ-ja dhe kemi bërë prapësimet tona. Pikërisht këtu jemi për t’u qëndruar prapësimeve dhe përgjigjes që kemi kthyer. Në

*Zbardi materialin audio  
Alma KOLA*

 2

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

fakt, në asnjë momenti nuk kemi postuar postime politike që lidhen me aktivitete politike të ministres apo më tej, kemi postuar të gjitha punët që janë bërë në të mirë të sistemit arsimor. Nuk kemi pasur informacione në lidhje me hashtagët e përdorur. Në momentin që kemi marrë këtë informacion nga KQZ-ja...

**Z. I. Celibashi:** Cila ka qenë përmbajtja e këtyre hashtagëve?

**Përfaqësuese e ZVA, Durrës:** Përmbajtja e hashtagëve ka qenë puna e bërë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në të mirë të sistemit arsimor dhe në asnjë moment nuk ka qenë postim politik. Këtë e konfirmojmë edhe në faqet tona zyrtare.

**Z. I. Celibashi:** Përmbajtja e hashtagëve në vetvete, jo mesazhi që kanë përcjellë ato.

**Përfaqësuese e ZVA, Durrës:** “Shqipëria 2030”, “Krenar për Shqipërinë”, këta kanë qenë disa hashtagëve. Megjithatë, dua ta them, që nuk kemi pasur asnjë indicie apo informacion që këto hashtagë janë përdorur në fushatë. Sapo u mor denoncimi, janë fshirë të gjithë hashtagët dhe janë njoftuar të gjitha institucionet e ndërrvarësisë dhe këtë e konfirmojnë edhe faqet zyrtare. Të gjithë hashtagët që kanë informacione politike janë fshirë nga faqja zyrtare e Zyrës Arsimore Durrës. Janë marrë masa të mos përsëritet më e njëjta problematikë.

**Z. I. Celibashi:** Z. I. Celibashi: Faleminderit! Është dikush tjetër që do ta marrë fjalën në lidhje me denoncimin 16? Jo.

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Data 28.02.2025  
Ora 12:44**

**RENDI I DITËS**

*Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 18, datë 17.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.*

*Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 19, datë 17.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.*

*Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 20, datë 17.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.*

*Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 21, datë 17.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.*

**PJESËMARRJA:**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Znj. P. Doçaj**
- **OJQ:**      **KRIIK**
- **Të tjerë:**      **Përfaqësues të subjekteve të denoncuar**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me denoncimet 18, 19, 20 dhe 21. E njëjta natyrë është?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Znj. P. Doçaj:** E njëjta natyrë, ndryshojnë vetëm institucionet.

**Z. I. Celibashi:** Bëhet fjalë për të njëjtët hashtagë, për të njëjtën përmbajtje të hashtagëve.

**Znj. P. Doçaj:** “Krenar për Shqipërinë”, “Vetëm përpara”. Kanë të njëjtën përmbajtje.

**Z. I. Celibashi:** Ka dikush nga institucionet që është paraqitur këtu, që dëshiron të flasë në lidhje me këto denoncime?

**Znj. P. Doçaj:** T’i lexoj institucionet që janë të pranishme?

**Z. I. Celibashi:** Po.

**Znj. P. Doçaj:** Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zoti Ilir Proda, zonja Risena Xhaja, Drejtore e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Zoti Klevis Hysa, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, zoti Elio Muça, Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe subjekte të tjera të denoncuara janë: zonja Ardita Kuçi, Drejtor i Përgjithshëm Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural; zoti Ilir Ajdini, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; zoti Ali Kaxhaja, Drejtor i Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë; zoti Vullnet Gjolla, Drejtor i Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë; zoti Pjerin Spathari, zoti Gentian Selami, zonja Jonida Boçi, zoti Ledion Lako, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

**Z. I. Celibashi:** Ndonjë prej personave që iu dëgjua emri dëshiron të flasë?

**Znj. P. Doçaj:** Është në lidhje me denoncimin nr. 18.

**Z. A. Dervishaj:** Faleminderit, zoti Komisioner! Quhem Albert Dervishaj, jam përfaqësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ilir Proda. Prapësimet në lidhje me çështjen që trajtohet janë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 238/15, datë 18.2.2025, ku kemi argumentuar të gjithë thelbin e problematikës për të cilën ka filluar shqyrtimi administrativ. Ajo që dua të theksoj është që të siguroj, të garantoj KQZ-në, subjektet elektorale dhe ato monitoruese të këtij procesi të rëndësishëm se Policia e Shtetit në zbatim të misionit të saj të përcaktuar në nenin 6 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” dhe të akteve të tjera të KQZ-së dhe të ligjit zgjedhor do të veprojnë dhe vepron në çdo rast me paanësi si një institucion i depolitizuar. Nuk përkrah asnjë forcë politike apo subjekt elektoral dhe nuk kemi raste të kësaj natyre në veprimtarinë tonë praktike të shpërndarjes së hashtagëve apo të formave të tjera. I vetmi rast që është evidentuar në datën 31 janar është një rishpërndarje e një postimi të Ministrit të Brendshëm, i cili kishte të bënte me një aktivitet të Policisë së Shtetit. Ju lutem, kërkojmë që të merren në konsideratë prapësimet e paraqitura. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, zoti Dervishaj, për shpjegimet e dhëna nga ana juaj!  
Zonja?

**Znj. A. Gjoni:** Jam Antoneta Gjoni, përfaqësuese e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural. Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural është person juridik

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe implementon të gjitha skemat mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Një ndër postimet që është shpërndarë në kuadër të informimit, është edhe një skemë e re që është mbështetja financiare për bujqësinë dhe sipërmarrjen në fshat. Qëllimi i shpërndarjes dhe komunikimit në rrjetet sociale ka qenë pikërisht informimi dhe jo përkrahja dhe asnjë lloj partie apo për qëllime elektorale. Sapo ka ardhur imeli për denoncimin, janë marrë masat e menjëhershme për fshirjen e tij dhe fshirjen e çdo lloj postimi që mund të kishte ndonjë slogan, që mbështeste në mënyrë të tërthorë çdo lloj partie politike. Gjithmonë ka qenë për qëllime informimi për masën e gjerë në lidhje me politikat bujqësore që ofrohen dhe mbështeten për bujqësinë. Megjithatë, edhe po t'i referohemi nenit 91 të Kodit Zgjedhor thotë: “Burimet publike nuk lejohen të përdoren gjatë fushatës zgjedhore”. Po të shkojmë te neni 71, fushata zgjedhore është 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Në këtë rast, nëse kthehem te denoncimi, përdorimi i burimeve publike nuk lejohet 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Është e paqartë në çfarë momenti, as katërmujori, as 30 ditë, thjesht thotë “fushatë zgjedhore”. Po të shkojmë te fushata zgjedhore, neni 77, thotë që fushata zgjedhore fillon 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve, që në këtë rast janë më 11 maj. Megjithatë, janë marrë masat e menjëhershme, siç e citova, për fshirjen e tij.

**Z. I. Celibashi:** Për dijeninë tuaj, por edhe të pranishmëve këtu, por edhe për këdo tjetër që do të ketë rastin ta dëgjojë shpjegimin vijues, keqpërdorimi apo përdorimi i aseteve publike për qëllime politike dhe elektorale është i ndaluar gjatë gjithë ditëve të vitit, gjatë gjithë orëve dhe minutave të vitit dhe jo vetëm gjatë periudhës zgjedhore, jo vetëm gjatë periudhës 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në krijimin e qeverisë së re. Por për periudhën 4 muaj deri në datën e zgjedhjeve deri në ditën e krijimit të qeverisë së re pas zgjedhjeve, është Komisioni Qendror i

*Zbardi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

Zgjedhjeve që monitoron veprimtarinë e institucioneve publike për mënyrën sesi ato u qasen aseteve publike. Por ndalimi për keqpërdorimin e tyre apo edhe për përdorimin e tyre për qëllime elektorale qëndron gjatë gjithë vitit.

Ka dikush tjetër që do të flasë në lidhje me denoncimet?

**Znj. A. Hodo:** Përshëndetje! Jam Albina Hodo, përfaqësoj Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe jam specialiste pranë këtij institucioni. Ka qenë një postim, i cili është përdorur nga ana jonë thjesht për promovimin e bregdetit dhe kanë qenë dy postime, dhe personi që merret me median sociale nuk ka pasur qëllimin e tillë për ta përdorur për slogane të Partisë Socialiste apo partive politike që ka përdorur atë hashtag. Kërkojmë mirëkuptimin tuaj, sepse nuk ka qenë qëllimi ynë për t'i përdorur këta hashtagë, siç ishte "Krenarë për Shqipërinë", sepse janë përdorur thjesht për promovimin kulturor të bregdetit të Shqipërisë në rrjetet sociale. Nga momenti që është marrë imeli nga KQZ-ja, është hequr menjëherë postimi, duke mos e përsëritur më dhe jemi gjithmonë në mbikëqyrje të postimeve që do bëhen në rrjetet tona sociale.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Ka dikush tjetër që do ta marrë fjalën?

**Znj. K. Lamaj:** Përshëndetje! Jam Kleana Lamaj, përfaqësuese nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Jemi pjesë e denoncimit për share që i është bërë një aktiviteti të ministrit të Brendshëm. Në asnjë moment Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nuk ka pasur si objektiv të bëjë *share* një postim që ka lidhje me hashtagun. Në momentin që ne kemi shpërndarë postimin e ministrit të Brendshëm, i gjithë aktiviteti ka pasur lidhje me punën dhe funksionin që ka Agjencia e Administrimit

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Më lejoni t'ju bëj me dije që është e pamundur në momentin që bëjmë *share* që të heqim hashtagun por Agjencia në momentin kur mori njoftimin për denoncimin, e fshiu postimin. Gjithashtu, ju garantojmë që nuk do të kemi më të tilla problematika, sepse iu tërhoq vëmendja edhe stafit respektiv për këtë pjesë. Ju faleminderit dhe shpresojmë në mirëkuptimin tuaj.

**Z. I. Celibashi:** Dikush tjetër? Zonja.

**Znj. G. Llanaj:** Përshëndetje! Unë jam Gerantina Llanaj, përfaqësuese e Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë. Arsyeja pse ne jemi pjesë e denoncimit nr.20 është për shkak të një rishpërndarjeje nga ana e institucionit tonë në faqen e *facebook*-ut për një postim që kishte të bënte në faqen e ministri të Bujqësisë për një skemë të re financiare, që lidhet me bujqësinë dhe sipërmarrjen në fshat, ku në bazë të kësaj skeme do të mbështetej agropërpunimi, agrokultura, agroturizimi dhe shumë sektorë të tjerë të bujqësisë dhe ne si institucion një nga pikat tona kryesore është informimi i fermerëve. Kjo ka qenë arsyeja e rishpërndarjes së postimit. Nuk ishim në dijeni të hashtagëve të mëposhtëm, që kishin përmbajtje politike. Nuk ka qenë synimi ynë përkrahja e një partie politike dhe për këtë arsye ne kemi bërë prapësimet tona nëpërmjet imeilit në KQZ dhe në bazë të saj kërkojmë mirëkuptimin që të mos kemi penalitet. Është evidentuar që asnjë nga postimet nga momenti që ka filluar periudha zgjedhore të kihet në vëmendje që të mos ketë përmbajtje politike. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Është dikush tjetër që do ta marrë fjalën në lidhje me denoncimet? Jo.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

Faleminderit të gjithëve për prezencën dhe përgjigjen pozitivisht të ftesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të qenë pjesëmarrës në këtë seancë! Vlerësojmë, në fakt, edhe reagimin ndaj këtyre shqyrtimeve administrative nëpërmjet veprimeve konkrete, duke vlerësuar si shenjë të përgjegjshmërisë institucionale administrative të gjithsecilit prej jush apo të institucioneve tuaja, por për të gjitha rastet ku diskutimi është për natyrën e hashtagëve të përdorur, pra ato 3 hashtagët, dhe rishpërndarjen e tyre, tashmë kemi një praktikë të çelur si institucion. Në gjykimin dhe vlerësimin tim, përmbajtja e këtyre hashtagëve nuk është e karakterit elektoral dhe politik, deri tani kështu rezulton, edhe nëse nuk do të ishin fshirë hashtagët, në gjykimin dhe vlerësimin tim nuk jemi përpara ndonjë shkelje administrative tej faktit që ju keni reaguar në përgjigje të procesit administrativ të shqyrtimit. Për më shumë akoma, kur ju i keni fshirë, nuk është rasti për të vazhduar me shqyrtimin administrativ të këtyre denoncimeve. Për denoncimin nr. 16, për denoncimin nr. 18, për denoncimin nr. 19, për denoncimin nr. 20, për denoncimin nr. 21 ne do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ.

Duke përfunduar këtë pikë të rendit të ditës, gjithsesi shfrytëzoj rastin, meqenëse ju jeni këtu, për t'ju risjell edhe një herë në vëmendje që duhet të tregoni të gjithë kujdesin që do të duhet si funksionarë publik në këtë periudhë parazgjedhore dhe më shumë akoma gjatë periudhës zgjedhore për të pasur një ndarje të qartë ndërmjet asaj çfarë ligji ju lejon për t'ju angazhuar politikisht apo në veprimtari politike apo elektorale me funksionin tuaj publik. Duhet të jetë një ndarje e qartë me thikë. Nuk mundet që njëkohësisht të silleni edhe si të angazhuar politikë apo si veprimtarë politikë për ata që janë të tillë, nuk besoj që janë të tillë, me ushtrimin e detyrës publike. Kjo mund t'ju penalizojë. Dhe më shumë akoma, do të duhet të jeni të qartë që gjatë ushtrimit apo gjatë angazhimit politik apo elektoral, të mos shfrytëzoni

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.02.2025*

zyrën, pozicionin, asetet publike. Faleminderit! Ditë të mbarë për të gjithë! Seanca mbyllet nëse nuk kemi gjë tjetër.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

